

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6533
E premte, 11 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Kapen 91 kilogramë drogë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

I DËRGUARI I POSAÇËM I MBRETËRISË SË BASHKUAR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR,
SIR STUART PEACH, KA VIZITUAR KOSOVËN

FAQE 4-5

EMISARI BRITANIK MBËSHTET DIALOGUN KOSOVË - SERBI



I dërguari i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Sir Stuart Peach, të enjten ka dëgjuar qëndrimet e përfaqësuesve të Kosovës për dialogun Kosovë - Serbi. Ambasada britanike ka njoftuar se emisari Peach prioritet ka mbështetjen e procesit për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kurse liderët institucionalë kanë kërkuar nga emisari britanik që në procesin e Brukselit të respektohen sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës, duke u trajtuar si palë e barabartë në proces

AKTUALE



VDES ISH-MINISTRI I JASHTËM SLOVAK, EDUARD KUKAN F. 2

MINISTRI LATIFI BËN THIRRJE PËR VAKSINIM KUNDËR COVIDIT F. 7

'BASHKIMI I QYTETIT TË FERIZAJT' I NËNSHTROHET AUDITIMIT PUBLIK F. 6

KURTI BËN NDERIME PËR MON BALAJN DHE ARBEN XHELADININ F. 5

EKONOMI



AAK-ja E QUAN MASHTRIM ORDINER VENDIMIN E ZRRE-së, KËRKON NGA QEVERIA TA SHFUQIZOJË F. 8

MURATI PRANON STRATEGJINË SHTETËRORE TË BERZH-IT PËR KOSOVËN F. 8

SPORT



KOSOVA DHE SHQIPËRIA SHËNOJNË NGRITJE NË RENDITJEN E FIFA-S F. 10

Limaj ia bën të qartë Kurtit: Nuk ka marrëveshje me Serbinë pa LDK-në dhe UÇK-në FAQE 3



KRASNIQI DHE RAMA BISEDOJNË PËR NJË DINAMIKË TË RE POLITIKE NË MES TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vdes ish-ministri i Jashtëm sllovak, Eduard Kukan

BRATISLAVË, 10 SHKURT - Ish-ministri i Jashtëm i Sllovakisë, Eduard Kukan, ka vdekur në moshën 82-vjeçare, ka konfirmuar të enjten Ministria e Jashtme e Sllovakisë. “Duke shërbyer në kohë të vështira, ai ia kushtoi jetën ndërtimit të Shërbimit të Jashtëm të Sllovakisë. Vendimet e tij mundësuan anëtarësimin tonë në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Pa të historia e Sllovakisë mund të ishte krejt ndryshe”, ka shkruar Ministria e Jashtme sllovaqe në “Twitter”. Arsyet e vdekjes nuk janë bërë të

qarta. Kukan ka qenë edhe deputet i Parlamentit Evropian dhe shef i delegacionit të BE-së për Evropën Juglindore. Sa ka qenë në krye të delegacionit të BE-së, Kukan ka shprehur mbështetje për integrimin evropian të Kosovës, në veçanti për liberalizimin e vizave. “Ne do të vazhdojmë t’ju ndihmojmë në këtë aspekt, duke ju dhënë ndihmë dhe duke biseduar edhe me Komisionin Evropian, në mënyrë që kjo situatë diskriminuese për popullin tuaj, të zgjidhet dhe ju ta gëzoni

udhëtimin pa viza dhe të lirshëm në zonën Shengen”, ka thënë Kukan në tetor të vitit 2013. Kosova është vendi i vetëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, qytetarët e së cilës nuk mund të lëvizin lirshëm në vendet e BE-së. Kukan vjen nga Sllovakia, një nga pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 17 shkurt 2008. Më 22 janar të vitit 2013 Kukan ka deklaruar se inkurajimi i pesë vendeve të BE-së për ta njohur Kosovën “nuk është një inkurajim jokonstruktiv”.



Ukraina i quan stërvitjet Rusi - Bjellorusi “presion psikologjik”



KIEV, 10 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka quajtur “presion psikologjik” stërvitjet e përbashkëta ushtarake ndërmjet Rusisë dhe Bjellorusisë. “Grumbullimi i forcave në kufi është presion psikologjik nga fqinjët tanë”, tha Zelensky përmes një deklarate për shtyp. “Sot kemi mjaft forca për ta mbrojtur

vendin tonë me nder”, shtoi ai. Ushttrimet që do të zgjasin dhjetë ditë, do të zhvillohen përgjatë kufirit ndërmjet Ukrainës dhe Bjellorusisë. Rreth 30 mijë trupa ushtarake ruse pritet të marrin pjesë në këto stërvitje. Rusia mohon se ka plane që ta sulmojë Ukrainën, por u bënë thirrje Shteteve të Bashkuara

dhe aleatëve që të mos e pranojnë Ukrainën në NATO. Po ashtu, Kremli kërkoi që aleanca ushtarake NATO të mos zgjerohet drejt lindjes. Perëndimi i ka bërë thirrje Rusisë që të tërheqë më shumë se 100 000 trupat që ka stacionuar pranë Ukrainës, por Kremli është përgjigjur se mund të vendosë trupat e tij ku të dojë brenda territorit rus.

Protestuesit në Mal të Zi kërkojnë zgjedhje të reja

PODGORICË, 10 SHKURT - Mali i Zi Demokratik, një parti pjesë e shumicës së mëparshme qeverisëse në Mal të Zi, kërkoi mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Këtë kërkesë kjo parti e bëri gjatë një proteste në Podgoricë. Protesta me sloganin “Mbrojtja e vullnetit elektoral të qytetarëve” u drejtua nga zyrtarët e Demokratëve. Protesta u mbështet edhe nga deputetët dhe zyrtarët e Frontit Demokratik pro-serb. Ata, po ashtu, shprehën pakënaqësi për formimin e mundshëm të një

qeverie të pakicës, që është propozuar nga ish-partneri i tyre politik, Dritan Abazović, që është kryetar i Lëvizjes Qytetare URA. Demokratët, Fronti Demokratik dhe URA kishin formuar koalicionin qeverisës pas zgjedhjeve të mbajtura më 2020. Në këtë protestë morën pjesë disa mijëra qytetarë dhe aktivistë të subjekteve politike të cilët mbajtën flamuj shtetërorë dhe mbishkrime përmes të cilave u bëhej thirrje qytetarëve që t’i rezistojnë “vjedhjes së vullnetit elektoral”.

Beçiq më 7 shkurt u shkarkua nga posti i kryetarit të Kuvendit, pasi për largimin e tij nga kjo pozitë votuan 43 deputetë të Kuvendit. Ai deklaroi se një qeveri e re e mundshme varet nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e presidentit të Malit të Zi, Milo Gjukanović. Partia e Gjukanovićit humbi në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2020. Kjo protestë u mbajt në kohën kur Dritan Abazović po përpiqet që të arrijë marrëveshje me disa subjekte politike për formimin e një qeverie të pakicës.

Armenia arreston 19 persona nën dyshimin për spiunazh

JEREVAN, 10 SHKURT - Shërbimi i Sigurisë Kombëtare i Armenisë (HAAT) ka njoftuar se ka arrestuar 19 persona, që dyshohet se ishin anëtarë të një “rrjeti të spiunazhit” në këtë shtet të Kaukazit Jugor. HAAT ka bërë me dije të enjten se dhjetëra pjesëtarë të forcave të armatosura mund të jenë përfshirë në aktivitetet e një rrjeti spiunazhi që punon për një shtet të huaj. Por, ky

shërbim nuk zbuloi se për cilin shtet bëhet fjalë. Sipas këtij shërbimi, rekrutimi i spiunëve u bë përmes një shërbimi online takimesh, përmes të cilit zyrtarët ushtarakë armenë që kishin të dhëna të klasifikuara dhe dokumente, i kanë dërguar përmes këtyre shërbimeve dhe i janë bashkuar këtij rrjeti spiunazhi. Autoritetet armene thanë se



personat e rekrutuar janë paguar për dhënien e informacioneve sekrete të shërbimit të huaj sekrete. Në deklaratën e Shërbimit të Sigurisë Kombëtare të Armenisë u tha se gjatë aksionit janë kryer 30 bastisje, janë konfiskuar dokumente dhe gjësende të tjera, duke shtuar se aktivitetet e këtij rrjeti spiunazhi janë parandaluar.

KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), MEMLI KRASNIQI, KA ZHVILLUAR VIZITËN E PARË ZYRTARE NË SHQIPËRI PAS ARDHJES NË KRYE TË PARTISË

Krasniqi dhe Rama bisedojnë për një dinamikë të re politike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, po qëndron për vizitë zyrtare në Tiranë. Ai është takuar të enjten me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla dhe me kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. Në këto takime është theksuar nevoja e një dinamike të re politike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 10 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, po qëndron për vizitë zyrtare në Tiranë. Krasniqi në këtë vizitë po shoqërohet nga shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, nënkryetarët e partisë, Vlora Çitaku dhe Uran Ismaili dhe sekretari i përgjithshëm, Bajrush Xhemaili.

Krasniqi ka takuar kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me të cilin ka biseduar për ndërtimin e raporteve të mëtutjeshme në mes të dy shteteve. Krasniqi ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë me fat që kanë mbështetjen e pakushtëzuar të njëra-tjetrës në rrugën drejt zhvillimit dhe integritimit. "Takimet tona, më

shumë sesa zyrtare, gjithmonë kanë qenë miqësore e vëllazërore. Edhe sot, në vizitën time të parë zyrtare në Shqipëri, në cilësinë e kryetarit të PDK-së, kisha kënaqësinë ta takoj kryeministrin Edi Rama për një drekë pune. Me kryeministrin Rama diskutuam për ndërtimin e mëtutjeshëm të raporteve në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe për thellimin e bashkëpunimit tonë institucional. Të dy u pajtuam për nevojën e një dinamike të re politike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, për t'i përshpejtuar proceset dhe marrëveshjet e dakorduara më parë. Me kryeministrin Rama diskutuam edhe për rolin dhe faktorizimin e shqiptarëve në Ballkan dhe për procesin e integritimit euroatlantik të dy shteteve tona. Kosova dhe Shqipëria janë me fat që kanë



mbështetjen e pakushtëzuar të njëra-tjetrës, në rrugën përpara drejt zhvillimit dhe integritimit", ka thënë Krasniqi pas takimit. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka takuar edhe kryetarin e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla. Krasniqi ka thënë se Kosova ka çfarë të përfitojë nga përvoja e Shqipërisë. Ai ka vlerësuar se koordinimi institucional në mes të dy vendeve duhet të avancojë në nivele më të larta. "Në frymën e

një bashkëpunimi shumë të mirë, me Taulantin diskutuam për përgjegjësitë tona si politikanë, si parti politike dhe si grupe parlamentare, që të angazhohemi edhe më tej për përafrimin dhe koordinimin e agjendës shtetërore të dy vendeve tona. Shqipëria ka bërë një punë të madhe për avancimin e legjislacionit dhe stabilitetit institucional gjatë kësaj periudhe, andaj Kosova ka çfarë të përfitojë nga përvoja e Shqipërisë.

Raportin dhe koordinimin e shkëlqyeshëm që kemi pasur me institucionet e Shqipërisë, jemi shumë të përkushtuar dhe të vendosur që ta avancojmë në nivele më të larta", ka thënë Krasniqi pas takimit me Ballën. Në kuadër të kësaj vizite, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka takuar edhe kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Lindita Nikolla. Krasniqi ka thënë se me kryetaren Nikolla kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe për mundësinë e krijimit të platformave të përbashkëta të veprimit. "Partia Demokratike e Kosovës e konsideron prioritet shtetëror forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në të gjitha fushat, andaj do të vazhdojë të luajë rol qendror në këtë drejtim. Dy shtetet tona duhet të jenë bashkë e më të forta në rrugën e integritimit euroatlantik", ka theksuar Krasniqi.



Limaj ia bën të qartë Kurtit: Nuk ka marrëveshje me Serbinë pa LDK-në dhe UÇK-në

PRISHINË, 10 SHKURT - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa LDK-në dhe UÇK-në. Ai ka thënë se një individ ose një parti politike nuk mund ta përmbyllë dialogun me Serbinë. Limaj në një intervistë në "Dtp te Fidani" në "T7" ka thënë se është koha që Albin Kurtit duhet t'i shihet veprimi dhe jo fjalët pasi, sipas tij, kryeministri ndryshe ka thënë në të kaluarën e ndryshe është duke vepruar tani. "Kurrë nuk bëhet mbyllja e bisedimeve

me Serbinë pa dy faktorë historikë. E po u tregoj këtyre djemve se pa LDK-në dhe UÇK-në kurrë nuk mund të mbyllet marrëveshja me Serbinë. Janë këta dy faktorë! Kjo temë nuk është temë e qeverisë. Është temë historike. LDK-ja, deshën apo nuk deshën këta dhe UÇK-ja, janë themeluesit e lirisë dhe shtetit të Kosovës. Nuk mbyllet pa ta. Ju mund të negocioni si qeveri, munda të vini me një marrëveshje të negociuar, por pa e dhënë pëlqimin e këtyre dy forcave këtu nuk ka marrëveshje", ka thënë Limaj.



I DËRGUARI I POSAÇËM I MBRETËRISË SË BASHKUAR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR,
SIR STUART PEACH, KA VIZITUAR KOSOVËN

Emisari britanik mbështet dialogun Kosovë - Serbi

I dërguari i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Sir Stuart Peach, të enjten ka dëgjuar qëndrimet e përfaqësuesve të Kosovës për dialogun Kosovë - Serbi. Ambasada britanike ka njoftuar se emisari Peach prioritet ka mbështetjen e procesit për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kurse liderët institucionalë kanë kërkuar nga emisari britanik që në procesin e Brukselit të respektohen sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës, duke u trajtuar si palë e barabartë në proces

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 10 SHKURT - Emisari i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Sir Stuart Peach, i ka dhënë mbështetje dialogut Kosovë - Serbi. Gjatë vizitës në Kosovë, në takim me liderët institucionalë, zyrtari britanik ka dëgjuar qëndrimet e vendorëve për procesin, duke i inkurajuar për dialog. Ambasada e Britanisë në Kosovë ka vlerësuar se prioritetet e Peachit janë dialogu, çështja e trashëgimisë, krimet e luftës dhe çështja e personave të pagjetur. "Sir Stuart po punon për ta promovuar stabilitetin dhe prosperitetin në këtë rajon. Prioritetet e tij përfshijnë

punën me partnerët tanë në mbështetje të dialogut Kosovë - Serbi të lehtësuar nga BE-ja, inkurajimin e zgjidhjes së çështjeve të trashëgimisë siç janë krimet e luftës dhe personat e pagjetur dhe nxitja e zhvillimit ekonomik", është thënë në njoftimin e Ambasadës së Britanisë pas takimeve që zyrtari britanik ka pasur me liderët institucionalë. Ambasada e Britanisë ka treguar se në këto takime Peach ka dëgjuar nga dora e parë shqetësimet dhe qëndrimet e përfaqësuesve politikë të Kosovës. "Me shumë kënaqësi mirëpresim Sir Stuart Peach, të dërguarin special të kryeministrit në Ballkanin Perëndimor në Kosovë për vizitën e parë në rolin e tij të ri. Sot në mëngjes ai pati takime

me presidenten dhe kryeministrin dhe po takon edhe përfaqësues të partive të ndryshme politike për t'i dëgjuar prioritetet dhe shqetësimet e tyre nga dora e parë", ka vlerësuar Ambasada e Britanisë në Kosovë.

Kërkohet që Kosova të jetë e barabartë në dialog

Përfaqësuesit institucionalë të Kosovës kanë kërkuar nga përfaqësuesi i Britanisë së Madhe për rajonin që Kosova të trajtohet si palë e barabartë në dialogun me Serbinë. Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, duke e përgëzuar diplomatin britanik për detyrën dhe për rolin aktiv

të shtetit të tij në rajonin e Ballkanit, ka thënë se Mbretëria e Bashkuar është ndër aleatët kryesorë, me rol kyç në procesin e çlirimit, pavarësisht dhe shtetndërtimit të Kosovës.

Sipas saj, sa më i madh roli i këtij shteti në proceset e rëndësishme të rajonit, aq më të mëdha e më të dobishme do të jenë rezultatet për qytetarët e Kosovës. "Duke folur për zhvillimet aktuale politike, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova është e përkushtuar ndaj dialogut si proces i përqendruar në njohje reciproke. Sipas presidentes Osmani, dialogu duhet t'i trajtojë palët në mënyrë të barabartë. Ajo ka përsëritur qëndrimin se pala e Kosovës është konstruktive në dialog dhe se Serbia po shkakton obstrukcione duke mos i zbatuar marrëveshjet e nënshkuara. Në këtë kontekst, ka përmendur edhe ndikimin negativ të Rusisë në rajon si një tendencë e hapur për destabilizimin e rajonit", është thënë në njoftimin e presidencës.

Edhe në takim me kryeministrin Albin Kurti, zyrtari britanik ka diskutuar për paqen e qëndrueshme, stabilitetin afatgjatë dhe sigurinë rajonale.

I pari i qeverisë ka falënderuar emisarin për ndihmën dhe mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar para, gjatë dhe pas luftës në Kosovë dhe shpalljes së pavarësisë. Sipas kryeministrit, Mbretëria e Bashkuar është partnere e Kosovës e domosdoshme për zhvillim dhe siguri. "Ai theksoi përkushtimin për ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve me Mbretërinë e Bashkuar duke vënë theksin te diaspora, si urë lidhëse për ta thelluar bashkëpunimin në sferën e investimeve, po ashtu edhe në atë të bashkëpunimit kulturor dhe njerëzor. E ardhmja e Kosovës është në NATO dhe në Bashkimin Evropian dhe roli i Mbretërisë së Bashkuar për përshtetimin e integritetit të Kosovës në NATO është qendror, e si hap i ardhshëm dhe i domosdoshëm është anëtarësimi i Kosovës në programin e NATO-s të

Kurti bën nderime për Mon Balajn dhe Arben Xheladinin

PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë të enjten homazhe te varri i Arben Xheladinit në Prishtinë dhe Mon Balajt në Podujevë, në 15-vjetorin e vrasjes së tyre. Ai ka bërë homazhe edhe te pllaka përkujtimore e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt në bulevardin "Nënë Tereza" në Prishtinë.

Fjalën e tij para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Kurti e filloi me fjalët e veprimtarit Adem Demaçi, i cili, më 10 shkurt të vitit

2007, në po të njëjtin shesh, kishte thënë: "Kjo është rruga jonë, rruga e Kosovës".

Kurti ka thënë se rruga jonë është e drejtë. "Atë 10 shkurt për të disatën herë ne e shpallëm hapur testamentin, që gjithkush ia shpallë vetvetes, testamentin e vetëvendosjes. Ne thamë se drejtësia nuk vjen nga jashtë, se kur drejtësia vjen nga jashtë, ajo është thjesht polici. Kërkuam vetëvendosje për popullin dhe kundërshtuam decentralizimin etnik dhe eksterritorialitetin fetar.

Ne thamë se na duhej shteti ynë dhe policët në shërbim të popullit", ka deklaruar kryeministri.

Më tej, ai ka thënë se "në vitin 1968, në vitin 1981, në vitet '88, '89, '90 e '91, pastaj në vitet '97, '98 e '99 dhe në vitin 2007, për të mbërritur në të tashmen tonë, kishim thënë gjithnjë se drejtësia nuk importohet, por është virtyt yni". "Me këtë dëshirë e me këtë besim, ne dolëm me mijëra në shesh, atë të shtunë të 10 shkurtit 2007. Po atë ditë ne deklarua se

është virtyt i demokracisë kjo dalje në shesh. Dhe policia arbitrare e UNMIK-ut na u përgjigj. Ajo donte të na mësonte një shtetim, pa demokraci. Ne ishim qytetarë të dorës së dytë, e për qytetarët e dorës së dytë nuk ka Kuvend, por polici, nuk ka gjykim, por hetim", ka deklaruar kryeministri Kurti, duke shtuar se përmes kësaj ngjarje dhe emrave të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt "do të takohen me nipat e fëmijët tanë në të ardhmen, ashtu siç e kemi bërë historikisht". "Ky është shesh,

është sheshi kur i vjen dëshmia dhe shtohet trashëgimia. 15 vjet më parë në këtë shesh ne kërkonim ende me vendosmëri të drejtën e rrugës së lirë të Kosovës, lirinë e së drejtës së Kosovës. Sot do ta vazhdojmë projektin e Republikës me një ndërtim më të denjë. E duam të lirë rrugën e saj, e duam të drejtë rrugën e saj, e duam të sigurt rrugën e Kosovës. Lavdi Mon Balajt e Arben Xheladinit dhe të gjithë dëshmorëve të popullit tonë!", ka thënë kryeministri Kurti.



Partneritetit për Paqe, proces i cili sjell stabilitet për rajonin, theksoi kryeministri", është thënë në njoftimin e Zyrës së Kryeministrit.

Kurse emisari Peach ka vlerësuar lart marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke shprehur gatishmërinë dhe vullnetin për ta thelluar bashkëpunimin, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe të sigurisë. "Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar në procesin e dialogut në Bruksel. Dialogu duhet të jetë parimor dhe ta respektojë barazinë e palëve dhe ku përfitues përfundimtarë janë qytetarët e jo politikanët, tha kryeministri Kurti. Ai ritheksoi që integriteti territorial, sovraniteti, funksionimi shtetëror, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, tërë kohën dhe kudo, të ngelen të pacenuara. Marrë për bazë përvojën e gjatë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, emisari

Peach shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e tij për të ndihmuar në procesin e dialogut", është thënë në njoftimin e qeverisë.

Një ditë më parë emisari britanik ka vizituar Serbinë.

Që nga fundi i janarit ai është duke vizituar vendet e rajonit, si Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Gjatë muajit janar Kosovën dhe Serbinë e kanë vizituar edhe emisarët e BE-së dhe ShBA-së. I dërguari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak dhe i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, kanë inkurajuar përfaqësuesit e të dy shteteve për dialog, duke i ftuar që t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në Bruksel.

BE-ja si ndërmjetësuese e procesit të dialogut Kosovë - Serbi është duke punuar për një takim të tretë në Bruksel në mes të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.



Kastrati: 'Ekoregjioni' t'i rritë kapacitetet për një ambient më të pastër në Malishevë

MALISHEVË, 10 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, bashkë me nënkryetarin Vesel Krasniqi, kanë takuar të enjten kryeshefin ekzekutiv të KRM "Ekoregjioni", Burim Shala, me të cilin kanë diskutuar për mundësinë e rritjes së kapaciteteve për

menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës.

Komuna e Malishevës meriton një ambient edhe më të pastër, dhe në funksion të kësaj kryetari Kastrati dhe nënkryetari Krasniqi kanë shprehur gjithë gatishmërinë

komunale për të ndërmarrë veprime konkrete për përkrahje të nismave që kontribuojnë në funksion të ruajtjes dhe pastërtisë së ambientit në gjithë territorin tonë. "KRM 'Ekoregjioni' t'i rritë kapacitetet për një ambient sa më të pastër në Malishevë", ka thënë Kastrati.



'Bashkimi i qytetit të Ferizajt' i nënshtrohet auditimit publik

FERIZAJ, 10 SHKURT (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka filluar auditimin e performancës në komunën e Ferizajt me temën "Menaxhimi i projektit bashkimi i qytetit të Ferizajt". Fokus kryesor i auditimit janë të gjitha fazat e projektit prej fillimit deri në përfundim të tij.

Objektiv i këtij auditimi është që të vlerësohet nëse komuna e Ferizajt ishte efikase për planifikimin dhe menaxhimin e projektit "Bashkimi i qytetit". Ky auditim synon të vlerësojë edhe nëse janë arritur objektivat e këtij projekti.

Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit në mes të komunës së Ferizajt dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, kjo e fundit është përgjegjëse për aspektin financiar të projektit, ndërsa komuna e Ferizajt për procedurat e prokurimit, përfshirë edhe menaxhimin e kontratës. "Komuna ka filluar zbatimin e



projektit në vitin 2018, një pjesë e tij është inauguruar në vitin 2021, ndërsa është duke u punuar edhe në pjesët e fundit që projekti të përfundohet në tërësi. Ndërtimi i projektit 'Bashkimi i qytetit' ka për qëllim uljen e aksidenteve në trafik, rritjen ekonomike/të hyrave të komunës përmes qirave dhe parkingjeve nëntokësore, uljen e fluksit të automjeteve dhe lehtësimin e qarkullimit për automjetet që janë në transit. Projekti i lidh dy pjesët e qytetit të

ndara nga hekurudha dhe ka vlerën mbi 5.5 milionë euro. Aktivitetet e prokurimit në komunën e Ferizajt, sikurse në çdo autoritet tjetër kontraktues, duhet të zhvillohen në pajtim me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë, parime të sanksionuara me Ligjin e Prokurimit Publik që kanë për qëllim të sigurojnë se prokurimi për mallra/shërbime/punë e arrin qëllimin e përcaktuar të Autoritetit Kontraktues", ka njoftuar Zyra

Kombëtare e Auditimit.

Kjo zyrë ka theksuar se duke pasur parasysh vlerën e lartë të projektit, rëndësinë që ka për qytetarët e Ferizajt si dhe duke qenë se është prej projekteve të rralla të kësaj natyre dhe të përmasave të tilla, është me interes për publikun që projektit t'i bëhet një vlerësim i përgjithshëm nga aspekti i efikasitetit dhe objektivave të synuara të projektit. "Subjekt i këtij auditimi do të jetë komuna e Ferizajt me njësitë vartëse siç janë:

Departamenti i Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Infrastrukturës. Departamenti i Financave në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përfshihet në fushëveprim sa i përket çështjes së pagesave të kryera në emër të projektit. Për të siguruar se zyrtarët e zgjedhur veprojnë në interesin më të mirë të qytetarëve që ata i përfaqësojnë, administrata publike duhet të jetë llogaridhënëse për administrimin dhe përdorimin e fondeve publike. Në këtë aspekt, Zyra Kombëtare e Auditimit është e përkushtuar që përmes auditimit të projekteve kapitale të një rëndësie si financiare ashtu edhe sociale ta forcojë llogaridhënien, transparencën dhe integritetin e administratës publike dhe aty ku është e mundur të ofrojë rekomandime që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase", ka njoftuar Zyra Kombëtare e Auditimit.

Komuna e Mitrovicës premtion projekte që do të ndikojnë në rritjen e punësimit

MITROVICË, 10 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim menaxherin e projektit të GIZ-it "Fit for Jobs", Tobias Seiberlich. Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi rreth projektit të GIZ-it "Fit for Jobs" të financuar nga qeveria gjermane, si dhe mundësia e bashkëpunimit me komunën e Mitrovicës. Projekti në fjalë synon ta risë punësimin

e të rinjve përmes përmirësimit të arsimit profesional të orientuar kah tregu i punës, orientimit në karrierë dhe përmirësimit të qasjes së të rinjve në shërbimet e tregut të punës. Menaxheri i projektit të GIZ-it "Fit for Jobs", Tobias Seiberlich, ka theksuar se është i interesuar ta mbajë bashkëpunimin e mirë me komunën e Mitrovicës, sidomos në sferën e vazhdimin të dialogut me aktorët lokalë për ta

përmirësuar punësimin e të rinjve dhe potencialisht aktivitetet e tjera për të cilat janë marrë vesh me partnerët politikë MFPT dhe MASHTI. Kryetari Hamza ka siguruar përfaqësuesit e GIZ-it gjerman se komuna e Mitrovicës është e gatshme ta fillojë realizimin e shumë projekteve që do të ndikojnë në rritjen e punësimit dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të Mitrovicës.



Drejtoria e Inspektorateve në Prizren fillon lirimin e hapësirave publike



PRIZREN, 10 SHKURT (ER) - Drejtoria e Inspektorateve në Prizren gjatë këtyre dy javëve ka vepruar në bazë të vendimit për rregullimin e qytetit dhe shërbimeve komunale, duke filluar me lirimin e hapësirave publike. Nga java e kaluar të gjithë prodhuesit e prodhimeve bujqësore, shitësit ambulantë dhe tregtarët që

merren me tregëtimin e produkteve të ndryshme janë larguar nga rrugët dhe trotualet dhe të njëjtët janë sistemuar në tregjet legale që ka komuna e Prizrenit. "Deri më tani intervenimet janë bërë në lagjen 'Bazhdarhane', në rr. 'Rrustë Kabashi', në rr. 'Fan S. Noli' afër çerdhes Yllka, në rr. 'Ahmet Prishtina' dhe në disa

lokacione të tjera brenda qytetit. Gjithashtu largimi i shitësve ambulantë është bërë edhe te tregu i veturave në rrugën magjistrale Prizren - Suharekë", ka njoftuar komuna e Prizrenit, duke shtuar se lirimi i hapësirave publike do të vazhdojë edhe në ditët e javët në vazhdim, në të gjitha zonat në komunën e Prizrenit.

Ministri Latifi bën thirrje për vaksinim kundër Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, u ka bërë thirrje të enjten qytetarëve të vaksinohen kundër Covid-19, duke theksuar se kjo është përgjigjja më adekuate që sot mund t'i jepet Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 10 SHKURT - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Rifat Latifi, u bëri thirrje qytetarëve të komunës së Prishtinës dhe jo vetëm që të vaksinohen kundër Covid-19, duke qenë që kjo është përgjigjja më adekuate që sot mund t'i jepet këtij virusi. "Në këtë ditë kaq të bukur, kur numri i rasteve po bie, mënyra më e mirë për t'iu përgjigjur Covid-19 është vaksinimi. Nëse sot të gjithë ne këtu i bindim nga dy veta për t'u vaksinuar, numri i të vaksinuarve do të rritet ndjeshëm. Unë i lus të gjithë qytetarët, të gjithë ata që nuk janë vaksinuar, që të vaksinohen me dozën e parë, të dytën, por edhe me të tretën. Nuk kemi zgjidhje tjetër. Vetëm në këtë mënyrë ne e mbajmë qytetin hapur, qytetin e bukur të Prishtinës, i mbajmë restorantet,

fushat sportive, të gjitha lokalet hapur, e mbajmë ekonominë hapur dhe jetën tonë e shkollat tona", ka thënë ministri Latifi. Ai këtë thirrje e ka bërë me rastin e hapjes së pikës së re të vaksinimit kundër Covid-19 në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë.

Ministri Latifi, bashkë me kryetarin e Prishtinës, Përparim Rama, shefen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Nona

Zicherman dhe përfaqësues të USAID-it, kanë bërë thirrje për vaksinimin e popullatës kundër Covid-19.

Kosova ka regjistruar katër viktima dhe 717 raste të reja me koronavirus, ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë të enjten.

Rastet e reja dolën pas testimit të 4 132 mostrave, që i bie se 17.35 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me

koronavirus.

Në raportin e Ministrisë së Shëndetësisë, që u referohet të dhënave të 24 orëve paraprake, bëhet me dije se janë shëruar edhe 2 370 pacientë, ndërkaq raste aktive me koronavirus janë 16 849.

Ndërkaq, sa i përket vaksinimit, në 24 orët paraprake janë administruar 1 355 doza të vaksinës kundër koronavirusit. Deri më tani me dy doza të

vaksinës janë imunizuar 809 613 persona.

Nga 10 shkurti qytetarët në Prishtinë mund të vaksinohen edhe në sheshin "Zahir Pajaziti".

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga mosha 12-vjeçare. Ndërkaq, dozën përforcuese dhe atë të tretë mund ta marrin të gjithë personat nga mosha 18-vjeçare, të cilët para tre muajsh janë imunizuar me dy doza të vaksinës.

Kapen 91 kilogramë drogë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 SHKURT - Policia e Kosovës, pas një operacioni kundër drogës, në të cilin ka konfiskuar 91 kilogramë narkotikë të llojit marijuanë, ka mbajtur një konferencë për medie.

Majori i policisë, Reshat Murseli, ka thënë se aksioni është zhvilluar të mërkurën në mbrëmje. Sipas tij, ky operacion ka rezultuar me arrestim dhe konfiskim të një sasive të konsiderueshme të narkotikëve. "Hetuesit kanë monitoruar lëvizjet e tyre dhe kanë dhënë

urdhër për ndalje. Të dyshuarit kishin edhe armë. Në cilësi të provave janë konfiskuar 34 paketime me substancë narkotike marijuanë mbi 91 kilogramë. Janë kontrolluar shtëpitë e të dyshuarve dhe është arrestuar F. M., 55 vjeç. Deri më tani një i dyshuar është arrestuar dhe policia është në kërkim të tre personave të tjerëve. Hetimet janë duke vazhduar dhe po koordinohen me Prokurorinë Themelore. Hetimet flasin se droga ka origjinë nga Shqipëria dhe ka kaluar në drejtim të Podujevës dhe ka pasur destinim final vendet e BE-së", ka bërë me dije Murseli.

Më 2021 janë kryer mbi 2 000 operacione në spitalin e Mitrovicës

MITROVICË, 10 SHKURT (ER) - Në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës, sipas të dhënave vjetore të punës, janë kryer 2 095 operacione gjatë vitit 2021. Në këtë spital vitin e

kaluar janë kryer 1 561 lindje, 581 me operacion, ndërsa numri i foshnjave të lindura ka qenë 1 574.

Nga janari deri në dhjetor janë kryer 125 141 vizita

ambulantore, 28 834 vizita diagnostike, kurse 27 805 kërkuan ndihmë mjekësore në Repartin e Emergjencës.

Për 12 muaj në Spitalin e Mitrovicës janë kryer edhe 2

726 CT, 5 179 ultrazë dhe 15 892 radiografi.

Në bazë të raportit njëvjeçar të punës, në këtë spital janë bërë 170 760 analiza laboratorike dhe 10 743 dializa.



Murati pranon strategjinë shtetërore të BERZh-it për Kosovën

PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pranuar të enjten nga udhëheqësi i zyrës së BERZh-it në Prishtinë, Neil Taylor, strategjinë shtetërore të BERZh-it për Kosovën (2022-2027).

Strategjia, e cila zhvillohet në

koordinim me institucionet vendore, identifikon fushat në të cilat BERZh-i është më së miri i pozicionuar për ta ndihmuar Kosovën dhe paraqet konditat për zhvillimin e projekteve të reja me përkrahjen e BERZh-it gjatë viteve 2022-2027.

Ministri Murati me këtë rast ka

vlërësuar lart bashkëpunimin me BERZh-in, si një partner i fuqishëm për arritjen e objektivave të qeverisë drejt zhvillimit dhe forcimit të performancës së sektorit privat në Kosovë, përkrahjes së tranzicionit drejt energjisë së pastër, përmirësimit të ambientit dhe zhvillimin

infrastrukturor.

Prioritetet kryesore të kësaj strategjie janë: zhvillimi i një sektori privat më konkurrues dhe gjithëpërfshirës për të mundësuar rritje ekonomike, mbështetja e tranzicionit të ekonomisë së gjelbër në Kosovë përmes diversifikimit të burimeve të energjisë dhe

efikasitetit më të madh për përdorimin e burimeve dhe mbështetja e integritit rajonal infrastrukturor drejt tërheqjes së investimeve të huaja.

Gjatë këtij takimi palët u zotuan për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre me qëllim që ta përmirësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës.



AAK-ja e quan mashtrim ordiner vendimin e ZRRE-së, kërkon nga qeveria ta shfuqizojë

PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i ka bërë thirrje Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike që të tregohet transparente dhe të tregojë çmimin real të shtrenjtimit të energjisë elektrike. Përmes një komunikate për medie, AAK-ja ka thënë se kanë kaluar 48 orë prej kur ZRRE-ja e rriti në mënyrë drastike çmimin e energjisë elektrike dhe ende nuk ka transparencë se si po përdoren paratë e taksave të



qytetarëve për subvencionim. "Kanë kaluar 48 orë prej kur

ZRRE e rriti në mënyrë drastike çmimin e energjisë elektrike dhe

akoma nuk ka transparencë se si po përdoren paratë e taksave të qytetarëve për subvencionim. Paratë tuaja, qytetarë të nderuar, Kurti po i përdor për të fshehur dështimin e tij dhe për të thënë se 'tryma për 800 kilovatët e parë nuk shtrenjtohet'. Është e vërtetë që në faturë kjo pjesë nuk do figurojë, por shtrenjtimi do të ndodhë, veçse diferencën e paguan qeveria, po me paratë tuaja. Plus ky subvencionim do të hiqet fundvitin e ardhshëm dhe prapë barra do të jetë individuale e juaja", thuhet në

njoftimin e AAK-së.

AAK-ja ka theksuar se prej dje shteti do të jetë më i varfër e me këtë edhe qytetarët do të jenë më të varfër. "I bëjmë thirrje ZRRE-së dhe qeverisë që të tregojnë transparencë dhe menjëherë ta tregojnë çmimin real dhe mënyrën e ndarjes së 100 milionë eurove të taksave tona. Si rrjedhojë e këtij mashtrimi ordiner, i bëjmë thirrje qeverisë që ta shfuqizojë vendimin për shtrenjtimin e rrymës", thuhet në njoftimin e AAK-së.

Byroja e Sigurimeve kërkon nga fermerët t'i sigurojnë traktorët

PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) - Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) u ka bërë thirrje fermerëve që t'i regjistrojnë traktorët për shkak të numrit të madh të aksidenteve nga ta. Sipas njoftimit të BKS-së, gjatë dhjetë vjetëve të fundit BKS-ja ka paguar rreth 2.2 milionë euro

dëme nga aksidentet e shkaktuara nga traktorët e pasiguruar. "Më shumë se 2.2 milionë euro ka arritur deri më tash shuma e mjeteve që Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) ka paguar për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga traktorët e pasiguruar.

Përfaqësues të BKS-së apelojnë te fermerët që t'i regjistrojnë mjetet e tyre pasi që, sipas tyre, në rast të aksidenteve pa sigurim, BKS-ja kompenson palën e dëmtuar, por më pastaj të gjitha mjetet rimburohen nga shkaktori i aksidentit", bëhet me dije në njoftimin e BKS-së.



Britani e Madhe: Gratë, së shpejti në pushtet



Liz Truss përgjegjëse për Punët e Jashtme, Nadine Dorries, Ministria e Kulturës, Angela Rayner numri dy i Punës ... Të gjitha ambicioze dhe në garë për poste drejtuese. Sigurisht, shumë varet nga fati i Boris Johnson. I cili është në duart e një gruaje tjetër, Sue Grey: zyrtarja që heton festat e ndaluara në Downing Street.

Tetorin e kaluar, kamerat e kapën tek vizitonte Bristol Aerospace, duke buzëqeshur me publikun, së bashku me Boris Johnsonin, e zhvendosur pak më përpara, si në një garë. Liz Truss është një nga gratë kryesore në politikën britanike, e gatshme për të rrëzuar liderët e vet. Në një vend që ka pasur dy herë gra në krye të qeverisë, ato presin vetëm rastin e duhur dhe nuk kanë frikë nga asgjë, për të shkuar në vendin e parë.

Ndërsa kryeministri Boris Johnson lëkundet, i trazuar nga skandalet e festave në shoqëri, kur bashkatdhetarët e tij ishin mbyllur në shtëpi në izolim, ministrja e Jashtme, me përgjegjësi për Brexit vazhdon të vrapojë dhe është gati të përdorë arritjet e saj, për të fituar sfidën e radhës për lidershipin e partisë. Sondazhet e tregojnë krah për krah me Rishi Sunak i cili vetëm pak muaj më parë ishte i paracaktuari si pasardhës në krye të partisë.

Por Liz, 46 vjeç, gjithmonë ka menduar se mund t'ia dalë, edhe kundër heroit që shpëtoi ekonominë britanike. Ajo mund të mburret me një nga karrierat më të gjata aktuale politike, me poste ministrore nën të gjitha qeveritë konservatore, nga Cameron tek May e deri te Johnson.

E rritur në një familje të arsimuar dhe të qendrës së

majtë (babai i saj ishte mësues matematike, nëna e çoi në protestat anti-bërthamore), zonja tashmë është riemërtuar nga analistët politikë si "Thaçeri i ri", një pseudonim që herët a vonë prek të gjitha femrat në karrierë në parti. Jo se ajo nuk bën të vetën, për të theksuar ngjashmërinë me Zonjën e Hekurt: me rastin e Krishtlindjeve të fundit, kartolina e saj e urimit fotografonte një ambicie të pamasë, e shfaqur pa turp: ulur në dhomën e punës të shtëpisë së saj në Greenwich, kompletuar me oxhak të ndezur dhe flamurin kombëtar që pikasej qartë pas shpine, ajo dukej se kishte arritur tashmë në vijën e finishit. Në të njëjtën Krishtlindje, Boris Johnson zgjodhi të uronte zgjedhësit e tij me një foto të qenit të tij të vogël e shumë të dashur.

Por zonja nuk është ajo që përqendrohet te humori për të fituar, ajo preferon qasjen pragmatike me të cilën ndjek qëllimet, cilatdo qofshin ato. Zgjidhja e nyjës irlandeze, në frontin e Brexit, është arma e saj më e fuqishme, për të zëvendësuar një Johnson që shumë e konsiderojnë të jetë në fund të radhës. Pas braktisjes së paraardhësit të tij Lord Frost, ai adoptoi një praktikë më të butë me Evropën për të thyer ngërçin në negociatë, për të rivendosur qetësinë e përkohshme në

Irlandën e Veriut dhe për të lejuar Londrën dhe Brukselin të rifillojnë të flasin, pa spektrin e çarjeve të reja, për të hapur më pas një front të përbashkët kundër kërcënimeve nga Kina dhe Rusia.

Ditët e fundit, politika e tij ka çuar në një konferencë të përbashkët shtypi – e para pas disa muajsh grindjesh – në të cilën nënkryetari i Komisionit Evropian Maros Sefcovic ka folur për mundësinë e "një marrëveshjeje në kohë, nëse ruhet vullneti i mirë politik".

Në fund të fundit, Liz, në referendumin e 2016-ës kishte votuar për të qëndruar në BE; më shumë sepse mendonte se do ta fitonte këtë rol, sesa me bindje, thonë thashethemet. Por tani ajo duhet të jetë e kujdesshme që të mos imitojë anëtarët më të ashpër të Brexit, nëse vërtet dëshiron të fitojë kreun e partisë. Ndërkohë, teksa në shtëpi po masakrohej shefi i saj nga polemikat, ajo qëndroi në distancë, duke dhënë përfundimisht mbështetjen e saj, vetëm që të mund të bënte publikisht thirrje për "një ndryshim kulture në Downing Street".

Një lëvizje që Nadine Dorries, Ministre e Arteve, Dixhitalizimit dhe Kulturës, sigurisht që i qorton, duke pasur parasysh se sa shumë po bën ajo për të mbajtur BoJo në post. Media kombëtare rrëfen se meqë

shpërtheu "bomba" e gjoja shantazhit nga kamxhikët (deputetët që bëjnë lidhjen mes deputetëve të tjerë dhe kreut të partisë), ajo po punon furishëm në prapaskenë për të bindur rebelët që të mos i paraqesin kryeministrit kërkesat e mosbesimit, të cilat po grumbullohen në tryezën e komisionit të brendshëm parlamentar.


Dhe në të njëjtën kohë arriti kulmin e përplasjes me BBC-në, e cilësuar si "fajtorë" për armiqësi ndaj qeverisë, duke ngrirë shumën e tarifës së licencës për dy vitet e ardhshme, dhe duke kërcënuar me anulimin e saj menjëherë më pas. Nga kjo ish-infermiere e klasës punëtore, në të kaluarën e pezulluar përkohësisht nga partia për shkak të pjesëmarrjes në versionin televiziv britanik të Ishullit të të Famshmëve, Boris Johnson nuk ka frikë nga goditja, të paktën në të ardhmen e afërt. Trashëgimia e saj kulturore dhe familjare forcon lidhjen me shtresat më të varfra dhe më populiste të elektoratit. Nëse Johnson mund të përballojë të injorojë çmimin e qumështit, kjo ndodh sepse ajo e di dhe mburret se mund të thotë atë që mendon, edhe kur nuk është aspak e vërtetë. Dhe ka shumë afërsi karakteriale dhe personale midis kësaj "ushtareje të

kryeministrit" dhe koleges së saj në sportelet përballë Westminster, numri dy laburist, Angela Rayner.

Vetëm se ajo, të moderuarin Sir Keir Starmer, e frikëson më shumë se djalli. Tani për tani, lideri i opozitës është i zënë me frenimin e ambicieve të nxënëses së tij, e cila po rezulton shumë më e rrezikshme se sa pritej. E rritur në Stockport, në një banesë sociale në lagjet e varfëra të Manchesterit, me një prind bipolar për të cilin ajo kujdeset që në moshën 10-vjeçare, kjo nënë beqare që e la shkollën kur mbeti shtatzënë në moshën 16-vjeçare, u zgjodh në Westminster në vitin 2015. Vullneti prej çeliku!

Ministre hije me Jeremy Corbyn, ajo kandidoi për nënkryetare pas katastrofës zgjedhore të vitit 2019, duke u bërë krahu i djathtë i Starmerit, me një mandat të brendshëm unanim. Ajo bëri "punën e pistë" për të, duke thënë atë që Sir Keir nuk mund ta kishte thënë kurrë. "Konservatorët janë llum, një tufë mizogjinësh, racistësh" ishte një nga deklaratat e saj më të ndezura dhe më kontroverse. Starmer u përpoq ta nxirrte jashtë në një riorganizim, për të cilin ajo as nuk ishte në dijeni, por ishte i pasuksesshëm. Dhe tani që partia ka erën në velat e veta, zonja i ka thënë transmetuesit amerikan CNBC: "Do të ishte një nder për mua të hyja në Downing Street me Keir". Dhe nëse ajo shkon atje si kryeministre, e pyeti gazetari. "Kurrë mos thuaj kurrë", ishte përgjigja.

Sigurisht, gjithçka do të varet nga fati i Boris Johnsonit, i cili është në duart e një gruaje, më e fuqishmja: Sue Grey, nëpunësja e lartë civile e ngarkuar me hetimin e festave në Downing Street gjatë izolimit. Emri i saj më parë ishte i njohur vetëm për personat e brendshëm, por ish-ministri i kabinetit Oliver Letwin e ka quajtur atë "personi që drejton Britaninë e Madhe". Dhe nëse ajo e drejton si pijetoren e Irlandës Veriore që zotëronte prej disa vitesh, në periudhën e trazirave, me burrin e saj, ku katolikët dhe protestantët mblidheshin për të pirë, atëherë do të shohim disa të mira. Grey mund të mos jetë në gjendje të largojë Johnsonin, por raporti i saj (i cili tashmë ka nisur një hetim policor për rastin) mund t'i japë fund karrierës së tij politike. Edhe për faktin se, kryeministri me shtatë jetë do të duhet ta bëjë publike herët a vonë. / Panorama Italia – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Tahiri shkruan historinë në Lojërat Olimpike Dimërore

Albin Tahiri është renditur i 15-ti në Lojërat Olimpike Dimërore "Pekini 2022". Ky sukses është më i miri në karrierë për Tahirin, por edhe për Kosovën në LOD. "Jam shumë krenar me rezultatin më të mirë për Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore. Është diçka e pabesueshme. Nuk e kam imagjinuar kurrë top 15-shin. Qëllimi im ishte hyrja në top 30, por sot arrita shumë më shumë. Unë jam shumë krenar. Rroftë Kosova!", ka deklaruar Tahiri



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 SHKURT - Skitari i Kosovës, Albin Tahiri, e ka shkruar historinë për sportin e Kosovës në Lojërat Olimpike Dimërore "Pekini 2022". Në fakt, Tahiri të enjten e ka zënë vendin e 15 nga 27 garues në disiplinën e kombinimit alpin, që përbëhet nga lëshimi dhe sllallomi, derisa në lëshim ishte i 22-ti. Kjo pozitë është më e mirë në karrierën e Tahirit në Lojërat Olimpike Dimërore, por edhe rezultati më i mirë për Kosovën. Koha e tij nga dy lëshimet ishte 2 minuta e 48.29 sekonda. Pas garës, Albin Tahiri ka folur për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës, ku

është shprehur krenar për suksesin e arritur. "Jam shumë krenar me rezultatin më të mirë për Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore. Është diçka e pabesueshme. Nuk e kam imagjinuar kurrë top 15-shin. Qëllimi im ishte hyrja në top 30, por sot arrita shumë më shumë. Unë jam shumë krenar. Rroftë Kosova!", ka deklaruar Tahiri, i cili është përgëzuar nga presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi. "Suksesi i sportit të Kosovës është në rritje, sidomos pas Tokios ku fituam dy medalje të arta. Sot është një tjetër lajm i mirë për Kosovën dhe Komitetin Olimpik të Kosovës. Albini u rendit në pesëmbëdhjetëshen më të mirë

në botë. Si kryetar i KOK-ut jam i lumtur me këtë të arritur", ka thënë Krasniqi, i cili ka folur edhe për Kiana Kryeziun. "Vetë ardhja e saj këtu është një arritje e madhe për Kosovën. Kiana është

garuesja e parë e Kosovës që merr pjesë në Lojërat Olimpike Dimërore. Ajo është 17-vjeçare dhe me shumë perspektivë. Ne do të punojmë me Federatën e Skijimit që në të ardhmen të kemi

edhe djem e vajza të reja që na prezantojnë në lojërat e ardhshme", ka shtuar Krasniqi. Skitari Albin Tahiri do të garojë edhe më 13 dhe 16 shkurt në sllallom të madh dhe sllallom.

Kosova dhe Shqipëria shënojnë ngritje në renditjen e FIFA-s

PRISHTINË, 10 SHKURT - Shtëpia më e madhe e futbollit botëror, FIFA, ka publikuar ranglistën e re për kombëtare. Kosova dhe Shqipëria kanë marrë lajme të mira nga kjo ranglistë e re. "Dardanët" janë ngritur për dy pozita në renditjen e re të FIFA-s dhe tash renditen në vendin e 109. Ndërsa Shqipëria është ngritur në tabelë për një pozitë. Kuqezinjtë nga vendi i 66-të që ishin muajin e kaluar, tani e shohin veten një pozitë më lart. Ndërkohë sa iu përket vendeve të para në renditje, Belgjika vazhdon të prijë në vendin e parë, duke lënë mbrapa Brazilin, Francën, Argentinën dhe Anglinë. Kampionia në fuqi e Evropës,



Italia, zë vendin e gjashtë, e shtata ndodhet Spanja, e teta Portugalia, e nënta Danimarka dhe top 10-shja mbyllet nga Holanda.

Drejtori i Chicago Fire: Shaqiri erdhi në çastin e duhur

CHICAGON, 10 SHKURT - Xherdan Shaqiri tashmë edhe zyrtarisht është lojtar i Chicago Fire. Shaqiri ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2024 me Chicagon dhe do ta veshë fanellën me numrin 10. Shaqa është blerë për 7 milionë euro nga Lyoni, duke u bërë kështu transferimi më i shtrenjtë në histori të klubit amerikan. "Ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur që tashmë e kemi Xherdan Shaqirin në Fire. Xherdani është një lojtar që ndryshon lojën dhe lojtar që do t'u sjellë gëzime tifozëve tanë dhe qytetit të Çikagos", ka thënë drejtori sportiv i Chicago Fire FC, Georg Heitz. "Si një nga më të mirët sot në Zvicër, Xherdani na bashkohet në një



moment shumë të rëndësishëm për klubin dhe beson plotësisht në objektivat dhe në atë që ne synojmë të arrijmë", ka deklaruar Georg Heitz.

Llapi - Gjilani dhe Ballkani - Prishtina, derbet e çerekfinalet e Kupës

PRISHTINË, 10 SHKURT - Dy ndeshje derbi do të zhvillohen në çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Shorti i hedhur të enjten në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës ka sjellë përballjet Llapi - Gjilani dhe Ballkani - Prishtina derisa në dy ndeshjet e tjera do të

takohen Drita - Ulpiana dhe Ramiz Sadiku - KEK-u. "Në praninë e Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për çerekfinale të Kupës së Kosovës. Skuadra fituese e këtij trofeu në edicionin e kaluar, Llapi, do të përballet

me Gjilanin, derisa një tjetër duel i fortë do të jetë ai ndërmjet Ballkanit dhe Prishtinës. Në dy ndeshjet e tjera do të takohen Drita - Ulpiana dhe Ramiz Sadiku - KEK-u", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ndeshjet e këtij rrethi zhvillohen më 16 mars.



Kampioni i NBA-së dhe fituesi i MVP-s nuk do të luajë asnjë ndeshje këtë sezon

LOS ANXHELOS, 10 SHKURT - Basketbollisti Kawhi Leonard, dy herë kampion në NBA dhe po dy herë fitues i trofeut MVP (2014 me San Antonio e 2019 me Toronto), këtë sezon nuk ka luajtur ende asnjë ndeshje me fanellën e clippersave. Ai u dëmtua gjatë fazës "play-off"

të vitit të kaluar (këputje e ligamentit të kryqëzuar të gjurit) dhe ende nuk ka rikuperuar, duke vijuar fazën e rehabilitimit. Mediet amerikane konfirmojnë se 30-vjeçari, një nga yjet e NBA-së, nuk do të zbrësë në fushë këtë sezon. "Me shumë gjasa,

Leonardo nuk do të kthehet të luajë basketboll këtë sezon", u shpreh Tyronn Lue, trajneri i clippersve. Një deklaratë që ka ulur shanset për ta parë Leonardin në fushë pavarësisht prej thashethemeve që thuhet për rikuperimin e tij. Clippersat

këtë sezon ndodhen në vendin e tetë, të fundit që të çon në "play-off", para rivalëve të lakersave. Duket se Kawhi Leonard do të jetë gati për sezonin e ardhshëm 2022-2023, për t'u rikuperuar 100 % nga dëmtimi, pa rrezikuar që të pësojë të tjera probleme fizike.



FBK-ja reagon pas incidentit në Pejë: Këto sjellje janë të papranueshme

PRISHTINË, 10 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka reaguar pas incidentit që ka ndodhur mbrëmë në Pejë ku është sulmuar autobusi i skuadrës së Sigal Prishtinës. FBK-ja kërkon nga organet e rendit që të identifikohen personat përgjegjës dhe ata të mos kenë më vend në palestrat e sportit. "Imazhe të tilla si ajo që ka ndodhur në Pejë janë të papranueshme për komunitetin e basketbollit, por edhe për sportin në përgjithësi. Federata e Basketbollit e Kosovës kërkon nga organet e rendit që të bëjnë përpjekje maksimale për t'i identifikuar këta persona në mënyrë që të tillat të mos kenë më vend në palestrat e sportit në vendin tonë. FBK-ja dhe organizatori i Final 8 Kupës së Kosovës, KB Peja, janë zotuar se organizimi i kësaj ngjarjeje prestigjioze do ta ketë sigurinë



më të lartë të mundshme, duke filluar nga ekipet, tifozët e të gjithë aktorët e tjerë që janë të përfshirë në të", thuhet në njoftimin shtesë.

Federata e Basketbollit e Kosovës, KB Peja dhe organet e rendit në Pejë do të vazhdojnë të garantojnë siguri për të gjithë aktorët deri në përmbyllje të kësaj ngjarjeje. "Do t'i marrim të

gjitha masat e nevojshme dhe do të shqiptojmë dënime për aktorët që bëjnë veprime të tilla, që nuk i kanë hije sportit, dhe që nuk përfaqësojnë asnjë vlerë sportive, por as edhe njerëzore. Final 8 Kupa e Kosovës duhet të jetë festë e të gjithëve, dhe assesi nuk duhet të jetë një event që frymon përçarje", thuhet në njoftimin e FBK-së.

15-vjeçarja ruse dyshohet për doping



PEKIN, 10 SHKURT - Një skandal ka ndodhur në Lojërat Dimërore të Pekinit. Është shtyrë ndarja e çmimeve për garën dhe shkak, sipas faqes së internetit "Insidethegames", është një test antidoping i dyshuar pozitiv nga 15-vjeçarja ruse Kamila Valieva përpara Pekinit. "Agjencia Ndërkombëtare e Testimit është në dijeni të raporteve që

qarkullojnë në lidhje me ceremoninë e shtyrë të ndarjes së çmimeve për garën e ekipit të patinazhit artistik. Çdo njoftim në lidhje me këto ngjarje do të publikohet në faqen e internetit", u shpreh një zëdhënës i organizatës së pavarur për shtyrjen "për arsye ligjore" të ceremonisë së ndarjes së çmimeve në Lojërat e Pekinit.

Situata është e komplikuar edhe më shumë sepse, sipas rregullave të Kodit Botëror Anti-Doping, Valieva është "person i mbrojtur" sepse "në momentin e shkeljes së rregullores antidoping ishte nën moshën 16 vjeç". Prandaj nuk mund të identifikohet zyrtarisht nëse është fajtorë për një shkelje të rregullores anti-doping, thekson "Insidethegames".

Nadal - Medvedev sfidë në Akapulko, rusi synon kreun e renditjes botërore

Grand slam i Australian Openit tashmë është lënë pas krahëve dhe tenistët po mendojnë për turnetë e tjerë. Djokoviçi do të luajë në turneun ATP 500 të Dubait,

ndërsa tenistët e tjerë "big" kanë zgjedhur të transferohen në Amerikë, ku do të luhen në mars turnetë e parë Masters. Spanjollja Rafael Nadal e rusi Daniil

Medvedev, dy finalistët e Australian Openit, kanë konfirmuar pjesëmarrjen në turneun ATP 500 të Akapulko (Meksikë). Pra, sfida e tyre vijon përtej oqeanit, me rusin

që synon kreun e renditjes botërore për meshkuj. Në këtë turne do të luajnë edhe disa tenistë të tjerë "big", si gjermani Alexander Zverev (numri 4 në botë), greku

Stefanos Tsitsipas (numri 3 në botë) e italianin Matteo Berrettini (numri 7 në botë). Në fushë do të jenë edhe bullgari Grigor Dimitrov e spanjollja Carlos Alcaraz.

SHKURT

Lewandowski ëndërron ta mbyllë karrierën në Real

Sulmuesi Robert Lewandowski thuhet se është i vendosur ta mbyllë karrierën në Real Madrid. 33-vjeçari ka qenë me Bayern Munchenin që nga viti 2014, duke përfaqësuar kampionët e Bundesligës në 358 ndeshje në të gjitha garat, duke shënuar 329 gola dhe duke kontribuar në 68 asistime në këtë proces. Marrëveshja aktuale e Lewandowskit në "Allianz Arena" do të skadojë në qershor 2023, megjithatë ka pasur një mori spekulimesh rreth së ardhmes së sulmuesit në muajt e fundit. Sipas "AS", sulmuesi polak dëshiron ta përfundojë karrierën në Real dhe është i interesuar për t'u bashkuar kësaj skuadre në afatin kalimtar të verës.

Rooney: Do të doja të isha trajner i Unitedit ose Evertonit

Wayne Rooney ka pranuar se dëshiron të drejtojë një ditë ish-klubin e tij, Manchester United. Rooney ka qenë një nga lojtarët më të mirë në histori të klubit nga "Old Trafford" dhe tashmë ka nisur zejen e trajnerit te Derby County në Championship. Megjithatë, synimi i anglezit është të rikthehet te "Dajtë e Kuq" si trajner, pas karrierës së bujshme si lojtar. "Manchester Unitedi dhe Everton, dy klubet që janë shumë afër meje, dhe shpresoj se një ditë në të ardhmen, nëse mund të menaxhoj një nga ato klube, do të ishte një arritje e madhe për mua", ka thënë Rooney.

Asensio: PSG - Real, nuk ka favorit

Futbollisti i Real Madridit, Marco Asensio, duke folur për ndeshjen e Ligës së Kampionëve që "mbretërit" e zhvillojnë ndaj PSG-së, ka thënë se në ndeshje të këtij lloji nuk ka favorit. "Në një ndeshje si kjo nuk ka favoritë. Do të përballemi me një skuadër shumë të fortë, por ne jemi Real dhe kemi besim se do t'ia dalim. Jam i bindur se kualifikohemi", ka deklaruar Asensio.

Interi, gati rinovimet me Handanoviçin dhe Perisiqin

Skuadra e Interit dëshiron të ecë përpara me këtë projekt që duket se po rezulton efikas dhe fitues. "Zikaltrit" lëvizën mirë në merkaton e janarit duke afuar lojtarë si Gosens dhe Caicedo, ndërsa në të njëjtën kohë vijnë punën për të blinduar disa nga titullarët më të rëndësishëm. Pas Brozoviçit, gjë gjithçka është mbyllur kohë më parë, drejtuesit ziklatër janë të bindur se të njëjtën gjë do të bëjnë edhe me dy titullarë të tjerë, Handanoviç dhe Perisiq. Për mesfushorin kroat kanë gati një kontratë dyvjeçare me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit dhe 3,5 milionë euro në sezon. Për Handanoviçin flitet për një kontratë njëvjeçare me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit dhe 3,2 milionë euro në sezon.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Në bazë të vendimit të Komisionit të posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, datë 9 shkurt 2022, publikohet:

FTESË / THIRRJE PUBLIKE

për

PARAQITJEN E NOMINIMEVE PËR DY (2) GJYQTARË NË
GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 114.1 të Kushtetutës dhe me nenet 4 dhe 6, të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, fton Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet gjyqësore, fakultetet juridike, Odën e Avokatëve, Shoqatën e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve, partitë politike, personat e tjerë relevantë juridikë dhe individët, që të propozojnë kandidatë për zgjedhjen e dy (2) gjyqtararëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Po ashtu, një person mund të propozojë veten për kandidat.

Komisioni në mënyrë të veçantë inkurajon gratë për të aplikuar.

Kualifikimet:

Kandidatët për pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; juristë të shquar me reputacion të shkëlqyeshëm profesional, me jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë pune profesionale, veçanërisht në fushën e së drejtës publike dhe kushtetuese të dëshmuar, *mes tjerash*, përmes punës profesionale si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, shërbyes civilë ose mësimdhënës universitarë dhe punë të tjera të rëndësishme të natyrës juridike, individë me reputacion të shkëlqyeshëm moral, të cilët kanë aftësi të plotë veprimi dhe të cilët nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale.

Të gjitha propozimeve dhe aplikacioneve për nominime, duhet t'u bashkëngjiten dokumentet si vijon:

- Formulari për nominimin e kandidatit;
- Formular të deklarimit të të nominuarit;
- Curriculum Vitae (C.V) (autobiografia);
- Letra e motivimit nga organizata ose institucioni propozues;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk janë të dënuar për ndonjë vepër penale.

Nominimet dhe aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më **2 mars 2022**, në orën **16:00**.

Nominimet dhe aplikacionet dërgohen personalisht në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë - Rr. "Nëna Terezë" p.n. Drejtoria e Personelit, Zyra N-217.

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: Në shërbimin përkatës të administratës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ose forma elektronike: në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës – www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnove odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 9. februara 2022. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA DVOJE (2) SUDIJA
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVO

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu sa članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužilaca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor dvoje (2) sudija Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda mora da budu državljani Republike Kosovo; istaknuti pravници sa odličnom profesionalnom reputacijom, ne kraćom od deset 10 (deset) godina stručnog rada, naročito u oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, *između ostalog*, putem stručnog rada sudija, tužilaca, advokata, civilnih službenika ili univerzitetskog predavača i drugih značajnih poslova pravne prirode; lica sa odličnom moralnom reputacijom, radno sposobni, koji nisu kažnjavani za krivična dela.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije mora se priložiti sledeća dokumentacija:

- Formular nominacije kandidata
- Formular deklaracije nominiranog,
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija"),
- Preporuka organizacije ili institucije koja ga predlaže,
- Dokaz da je građanin Kosova,
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije treba da se dostave najkasnije do **2. marta 2022. godine** u **16.00** časova.

Nominacije i aplikacije se lično dostavljaju na adresu:

Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština – ul."Majke Tereze", bb. Direkcija personala, Kancelarija N-217.

Aplikacije se mogu uzeti na sledećim mestima:

Formular: pri dotičnoj službi administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova - – www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova na br. telefona 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Na osnovu odluke Posebne komisije za razmatranje kandidata za imenovanje sudija Ustavnog suda, od 9. februara 2022. godine raspisuje se sledeći:

POZIV / JAVNI POZIV

za

PRIJAVLJIVANJE NOMINACIJA ZA DVOJE (2) SUDIJA
USTAVNOG SUDA REPUBLIKE KOSOVA

Posebna komisija za razmatranje kandidata za imenovanje u Ustavnom sudu, u skladu članom 114.1 Ustav Republike Kosovo i članovima 4 i 6 Zakona br. 03/L-121 o Ustavnom Sudu Republike Kosovo, poziva Skupštinu Republike Kosovo, pravosudne institucije, pravne fakultete, Advokatsku komoru, Udruženje sudija i tužioca, političke partije, druga relevantna pravna lica i pojedince da predlože kandidate za izbor dvoje (2) sudija Ustavnog Suda Republike Kosovo. Takođe, jedno lice može da predloži sebe za kandidata.

Komisija posebno podstiče žene da se prijave.

Kvalifikacije:

Kandidati za položaj sudije Ustavnog suda moraju biti državljani Republike Kosovo; istaknuti pravници odličnog profesionalnog ugleda, sa najmanje deset (10) godina radnog iskustva, posebno iz oblasti javnog i ustavnog prava, dokazanog, između ostalog, kroz profesionalni rad, kao: sudije, tužitelji, odvjetnici, civilni službenici ili sveučilišni predavači, te druge značajne poslova pravne prirode; osobe odličnog moralnog ugleda sa punom radnom sposobnošću, koji nisu bili kažnjavani za neko krivično djelo.

Svim predlozima i aplikacijama za nominacije moraju se priložiti dokumenta u nastavku, i to:

- Obrazac za nominiranje kandidata
- Obrazac deklaracije nominiranog
- Curriculum Vitae (C.V) ("autobiografija");
- Pismo motivacije / preporuka predlagača - organizacije / ustanove;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj stručnoj spremi.
- Dokaz o radnom iskustvu.
- Dokaz da nisu kažnjeni za krivično delo.

Nominacije i aplikacije dostaviti najkasnije do **2. marta 2022. godine, u 16:00 sati.**

Nominacije i aplikacije dostaviti osobno na adresi:
Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majke Tereze", bb.
Direkcija personala, soba br. N-217.

Aplikacije se mogu dobiti na sledećim mjestima:
Štampani obrazac: u dotičnoj službi Administracije Skupštine Republike Kosovo ili elektronskom poštom: web stranica Skupštine Republike Kosova:
www.assembly-kosova.org

Ostale dodatne informacije mogu se dobiti svakog radnog dana, do 16:00 sati, na telefonima: 038 211-182, 038 211-648, i 044 567-041.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Anayasa Mahkemesi'ne hakimlerin atanması için adaylar listesinin görüşülmesinden sorumlu Özel Komisyon'un 9 Şubat 2022 tarihli Kararı üzerine

KOSOVA CUMHURİYETİ ANAYASA MAHKEMESİNE (2) İKİ
HAKİM
ATAMALARIYLA İLGİLİ

ALENİ ÇAĞRI/ DAVET

Anayasanın 114.1 Maddesi ve Kosova Cumhuriyeti Anayasa Mahkemesi hakkında 03/L-121 sayılı Kanununun 4 ve 6. Maddeleri uyarınca Anayasa Mahkemesine Atama Adaylarının Gözden Geçirilmesi Özel Komisyonu, Kosova Cumhuriyeti Meclisi, yargı kurumları, hukuk fakülteleri, Avukatlar Odası, Hakimler ve Savcılar Birliği, siyasi partiler, diğer ilgili tüzel kişiler ve bireyler, Anayasa Mahkemesinin seçimi için iki (2) aday için, göstermek için Kosova Cumhuriyeti'nin. Ayrıca, bir kişi bir aday için kendini aday gösterebilir.

Komisyon özellikle kadınların başvuruda bulunmalarını teşvik etmektedir.

Kalifiyeler:

Anayasa Mahkemesi hakim görevine önerilen adaylar Kosova Cumhuriyeti vatandaşı olmalı; özellikle kamu ile anayasa hukuğu alanında ve diğerleri arasında hakim, yargıç, avukat, sivil memur ya da üniversite eğitmeni olarak çalışan ve diğer önemli hukuki işlerle uğraşan en azından on (10) yıllık çalışma görgüsüne ve bununla birlikte mükemmel uzmansal ünvanına sahip ünlü hukukçular olmalı; mükemmel ahlaki ünvanına sahip olmalı ve herhangi bir suçları için cezalandırılmış olmamalı.

Atamalarla ilgili tüm önerilere ve tüm formlara aşağıda saymış olacağımız şu evraklar ilave edilmelidir:

- Adayın atanmasına ait form,
- Atanan kişinin demeçte bulunmasıyla ilgili form,
- Curriculum Vitae (C.V) (özgeçmiş),
- Adayın önerildiği örgüt ya da kurum tarafından motivasyon belgesi,
- Kosova vatandaşı olduğuna dair delil,
- Öğretim ile uzmansal hazırlığına ait delil,
- Çalışma görgüsüne ait delil.
- Herhangi bir suç işi için cezalandırılmış olmadığına dair delil.

Atamalar ile formlar en geç **2 mart 2022** tarihine ve saat **16:00**'ya kadar gönderilmelidir.

Atamalar ile formlar şahsen şu adrese gönderilmelidir:
Kosova Cumhuriyeti Meclis Binası, Priştine, "Nëna Tereza" caddesi No'suz,
Personel hizmeti, Daire N-217.

Formlar şu yerlerden alınabilir:
Basılı şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin ilgili idari hizmetinde ya da elektronik şekli: Kosova Cumhuriyeti Meclisinin www.assembly-kosova.org web sayfasında.

Konuyla ilgili diğer ek bilgiler her iş günü saat 16:00'ya kadar şu telefon numaralarından alınabilir: 038 211-182, 038 211-648, ve 044 567-041.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



QENDRA E KOMPETENCËS "KUJTIM KRASNIQI" MALISHEVE
CENTRI E KOMPETENCËS "KUJTIM KRASNIQI" MALISHEVE

Numër: 113 /4
Datë: 09.02.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, dhe sipas nenit 12 Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë shpall:

Konkurs

Për regjistrimin e vijuesve për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve, për klasë e X- të në profilin:

1. Hoteleri dhe turizëm
2. Instalues elektrik

Në këtë afat do të pranohen 32 kandidatë për vijimin e Arsimin dhe Aftësimin për të rritur.

Afati do të jetë i hapur nga data 14.02.2022 e deri më 28.02.2022.

Kushtet

- Regjistrimi i vijuesve në programin " Arsimin për të rritur" bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në nenin 10.2 pikat (a, b) dhe nenit 17.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

-Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi [UA nr. 12/2011 MASHT].

Për regjistrim kanë të drejtë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesat e klasave të kryer paraprake
2. Certifikatën e lindjes
3. Fletëpagesën prej 150€ (e cila merret në shkollë), për regjistrimit e klasën së 10.

Dokumentet për regjistrim dorëzohen në shkollë.

Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimin të mesëm të lartë është me pagesë, participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr. 11/2011

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimin dhe aftësimin për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë :

1. Për regjistrim të vitit për një klasë, dhe punë praktike _____ 150.00€
2. Për ç' do provimin diferencial nga _____ 10.00€
3. Për provimet përfundimtare të klasës (certifikata dhe diploma) _____ 50.00€

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin do të i nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar në UA 12/2011.

Kandidatet të cilët e ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që paraprakisht ti nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Diplomat që merren në programin " Arsimi dhe aftësimi për të rritur janë të barasvlershme me diplomat e arsimin formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë , nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

ANADRINIA MED

SHKOLLA E MESME E LARTË E MJEKËSISË
PRIZREN

Rr."JONI", nr. 47, 20000 Prizren, Kosovë, email:kbiznesi@gmail.com
Tel: +383 44/49 500 878 : +383 29 230 555

Shkolla e Mesme e Lart e Mjekësisë "ANADRINIA-MED" bazuar në përgjegjësit e veta dhe duke respektuar Ligjin Nr. 06/0L-114 , Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, UA nr. 10/2018, si dhe neni 8 të Ligjit të Punës (Ligji 03-L-212, datë 01.11.2010, për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimin të përgjithshëm dhe UA Nr.05/015 i normativit për mësimdhënësit e arsimin profesional, vendosi të publikoj këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës mësimdhënës të lëndës:

1. Gjuhe Shqipe
2. Edukatë Fizike
3. Fizikë
4. Biologji
5. Kimi
6. Psikologji
7. TIK
8. Ndërmarrësi
9. Matematike
10. Gjuhe Angleze
11. Gjuhë Gjermane
12. Kujdes shëndetësor
13. Edukim shëndetësor dhe parandalim i infeksionit
14. Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut
15. Kujdes ndaj të sëmurave me sëmundje infektive
16. Farmakologji dhe dozologji
17. Shëndeti dhe sëmundjet e njeriut I dhe II
18. Kirurgji dhe përkujdesje
19. Shëndeti dhe sëmundjet të njeriut
20. Gjinekologji me obstetrikë
21. Biokimi klinike dhe diagnostikë laboratorike
22. Neuropsikiatri me kujdes
23. Mikrobiologji me imunologji
24. Kordinator të cilësisë
25. Administratë
26. Bibliotekistë/ arkivues
27. Shtëpiak.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (merret në shkollë);
- Diploma (Certifikata e diplomimit- nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e noterizuar nga organi kompetent;
- Ekstrakti i lindjes;
- Letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Vërtetimi nga gjykata se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale (në raste kur krijon marrëdhënie pune e obliguar);
- Dëshmi të trajnimeve arsimore të akredituara nga MASHT-i (nëse ka).

Kushtet:

Për këto vende të punës kërkohet përgatitja adekuate profesionale, konformë Udhëzimit Administrativ 10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimin të Përgjithshëm dhe për shkollat e larta profesionale UA Nr.05/015 i normativit për mësimdhënësit e arsimin profesional.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë në kopje (dokumenti për kualifikimin profesional i noterizuar), të cilat nuk kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen me rastin e intervistimit.

Kandidatët që e kanë mbaruar shkollimin jashtë Kosovës duhet t'i kenë dokumentacionet e nostrifikuara.

Kandidatët që i plotësojnë kushtet do të ftohen në test me shkrim apo intervistë .

Njoftimi për datën dhe vendin e mbajtjes së intervistës do të bëhet përmes telefonit apo emailit së aplikantit.

Afati i aplikimit është 15 ditë nga data e publikimit në Objektivin e shkollës në Prizren

Datë: 10.02.2022

Themelues

Dr Nexhmije Kabashi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

